



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI BASHKIAK

**Komisioni i Përhershëm i Mirëqenies Sociale Barazisë Gjinore Mosdiskriminimit
dhe të Drejtave të Njeriut**

Nr. 203

prot.



Fushë-Arrëz, më 24. 01. 2025

**PËR : KËSHILLIN E BASHKISË
FUSHË-ARRËZ**

Lënda: Relacion për projekt/vendimin “Për miratimin e listës së përfituesve të Ndhmës Ekonomike nga fondi i kushtëzuar i bllok-ndihmës ekonomike i 6% për muajin Dhjetor 2024”, që do t’i paraqitet Këshillit të Bashkisë për shqyrtim në mbledhjen e tij të datës 27.01.2025.

Ne zbatim te ligjit 139/2015 “Per vetëqerisjen vendore”, i ndryshuar, Rregullores për Funkcionimin e Këshillit të Bashkisë, Komisioni i Përhershëm i Mirëqenies Sociale, në mbledhjen e datës 24.01.2025 me pjesëmarrjen e anëtareve: Tereze Dema, Franc Doda dhe Pavlin Qafa, mori në shqyrtim projektin e miratimit të listës së përfituesve të ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar i bllok-ndihmës ekonomike i 6% për muajin Dhjetor 2024, paraqitur nga Sektori i Shërbimit Social.

Anëtarët e Komisionit janë njohur me projektin përmes materialit shkresor, nderkohe në mbledhjen e komisionit, shpjegimet i dha Drejtoresha e Emigracionit e Çeshtjeve Sociale, zj.Sidorela Katroshi, e cila shpjegoi se për muajin Dhjetor 2024 përfitojne ndihme ekonomike nga fondi i bllok-ndihmës i 6% , 33 familje, me fond **124,833** lekë nga fondi total i ndihmës ekonomike në vlerën **2,080,561** lekë dhe shpërndarë për përfituesit e 6% në Shumën **122,450** lekë sipas Njësive:

Bashkia Qendër Fushë-Arrëz 17 familje me fond **59,844** lekë.

Njësia Administrative Iballë 5 familje me fond **20,136** lekë.

Njësia Administrative Qafë-Mali 5 familje me fond **17,702** lekë.

Njësia Administrative Fierzë 2 familje me fond **6,752** lekë.

Njësia Administrative Blerim 4 familje me fond **18,016** lekë.

Për këtë muaj janë hequr nga skema e përfitimit per pike te pamjaftueshme:

1. Dallendyshe Mhill Nreca
2. Gëzim Hazir Arifaj
3. Gjeloš Kol Kola
4. Gjon Mark Malaj
5. Hil Zef Miceli
6. Mentor Mus Prela
7. Prend Ndue Kuraj
8. Rexhep Beqir Hasanaj
9. Shpresa Bib Hysaj

Franc Doda, anëtar i komisionit, pyet: Cilat jane arsytet qe keto familje kane dale nga sistemi?

Drejtoresha e Emigracionit e Çeshtjeve Sociale zj.Sidorela Katroshi, shprehet se keto emra i ka nxjerre sistemi per pike te pamjaftueshme dhe se do t'ju kërkojë informacion më të hollësishëm për këtë specialisteve të ndihmës ekonomike ne Njesite Administrative respektive.

Franc Doda anëtar i komisionit, thote se duhet te kontrollohen individet ku jetojne dhe si i kane kushtet ne menyre qe te trajtohen ato familje qe jane ne nevoje dhe qe plotesojne kriteret e perfitimit.

Anëtarët e komisionit kërkuar domosdoshmërisht zbatimin e kriterëve te perfitimit te 6%.

Anëtarët e komisionit kerkojne që të gjithë specialistët e Njësive Administrative të jenë të pranishëm në mbledhjet e Komisioneve dhe atë Plenare.


Pas diskutimit anëtarët e komisionit, me shumicë votash, ranë dakort me projektin e paraqitur dhe kërkuar miratimin e tij nga Këshilli në mbledhjen plenare duke kërkuar edhe mendime dhe propozime të tjera të këshilltarëve të pranishëm.

Duke kërkuar bashkepunimin tuaj!

Franc Doda



Pavlin Qafa



Tereze Dema

